




**INSTITUTI KOMBËTAR I SHËNDETËSISË  
PUBLIKE TË KOSOVËS**



**SITUATA EPIDEMIOLOGJIKE ME INFLUENCË, COVID-19 DHE  
PATOGENËT TJERË RESPIRATORË NË KOSOVË, SEZONA  
2025/2026 (JAVA 05-TË) – v.2**




**PËRMBLEDHJE**

Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike gjatë tërë vitit bën mbikëqyrjen permanente të Influençës sezonale (ILI), ARI dhe SARI me intensifikim të aktiviteteve gjatë sezonës përkatëse. Mbikëqyrja realizohet përmes hulumtimit aktiv dhe pasiv në institucione shëndetësore dhe terren.

**SITUATA EPIDEMIOLOGJIKE ME INFLUENCËN SEZONALE NË KOSOVË,  
2021/2022 - 2025/2026**

Sipas grafikonit 1, ku janë paraqitur rastet e Influencës sezonale (ILI) në 5 sezonat e fundit shohim se sezona 2025/2026 karakterizohet me numër më të ulët të rasteve të raportura, krahasuar me periudhën e njëjtë të sezonës 2024/2025 dhe fillim të aktivitetit nga java e 40-të e sezonës 2025/2026.

Grafikoni.1



**SITUATA EPIDEMIOLOGJIKE ME INFLUENCËN SEZONALE NË KOSOVË, 2025/2026  
DHE PRAGU EPIDEMIK**


Nga fillimi i sezonës, 29 shtator 2025 deri më 01 shkurt 2026 (java e 05-të) në Institutin Kombëtar të Shëndetësisë Publike të Kosovës janë raportuar 39,709 raste të Sëmundjes të ngjashme me Grip (ILI), 6,007 raste të Infeksioneve respiratore akute (ARI) dhe 50 raste me Infeksion të rëndë respirator akut (SARI).

Gjatë javës së 05-të (26.01.2026-01.02.2026) janë raportuar 1,741 raste ILI (Sëmundje e Ngjashme me Gripin), 279 raste ARI (Infeksion Respirator Akut) dhe 4 raste SARI (Infeksion i Rëndë Akut Respirator).

Përmes sistemit të mbikëqyrjes së sëmundjeve ngjitëse dhe paralajmërimit të hershëm (SMSN) janë raportuar 450 raste ILI, 29 raste ARI dhe 4 SARI.


**Intensiteti i Influencës sezonale sipas numrit të rasteve të raportuara për javën e 05-të paraqitet në aktivitetin e mesëm të ulët të qarkullimit dhe krahasuar me javën e kaluar shënon ulje prej 20.1%. (Graf.2)**

*Grafikoni.2*




Në grafikonin 3 shohim se në të gjitha komunat janë raportuar raste të dyshimta në Influencë dhe sipas numrit të rasteve të raportuara, numër më të lartë kanë komuna e Prishtinës, Mitrovicës, Pejës dhe Prizrenit ndërsa sipas Incidencës numër më të lartë të rasteve kanë komunat e Kamenicës dhe Mitrovicës. *Grafikoni.3*





Në raport me distribuimin e rasteve sipas grup-moshës dhe incidencës, nga numri total i rasteve të raportuara me ILI, shihet se të gjitha grup-moshat janë të atakuara derisa sipas Incidencës; grup-mosha 04 dhe mbi 65 vjeç. Sa i përket rasteve me ARI, grup-mosha më e atakuar është 0-4 vjeç (4,235 raste) pastaj grup-mosha 5-14 vjeç (763 raste), 15-64 vjeç (673 raste), dhe grup-mosha 65+ vjeç (336 raste). (Graf.4)

Grafikoni.4



Në laboratorin e Qendrës Kombëtare të Influençës – IKSHPK nga fillimi i sezonës 2025/2026 deri më 04 shkurt 2026, janë testuar gjithsej 3,181 mostra nga pacientët e qendrave sentinel dhe jo sentinel si raste të dyshimta në ILI, ARI dhe SARI. Nga mostrat e testuara 1,593 (50.1%) prej tyre të dyshimta në SARSCoV-2 dhe 1,588 (49.9%) të dyshimta në Influençë dhe patogjenët tjerë respiratorë. Gjatë kësaj periudhe në SARS-CoV-2 janë konfirmuar 20 raste (1.3%). Nga 1,588 mostrat e testuara në Influençë dhe patogjenët tjerë respiratorë janë konfirmuar 327 raste me Influençë A (pozitiviteti 20.6%). Rastet e konfirmuara me Influençë A janë nga komuna e Prishtinës (126 raste), Mitrovicë (55 raste), Fushë Kosovë (23 raste), Ferizaj (13 raste), Podujevë (14 raste), Malishevë (14 raste), Lipjan (11 raste), Vushtrri (10 raste), Drenas (8 raste), Kaçanik (6 raste), Skenderaj (6 raste), Gjakovë (5 raste), Viti (5 raste), Gjilan (4 raste), Suharekë (4 raste), Pejë (4 raste), Shtime (3 raste), Klinë (3 raste), Rahovec (2 raste), Graçanicë (2 raste), Kamenicë (2 raste), Prizren (2 raste) dhe me nga 1 rast komunitat : Novobërdë dhe Obiliq dhe i takojnë grup-moshës 0-4 vjeç (151 raste), 5-14 vjeç (85 raste), 15-34 vjeç (36 raste), 35-50 vjeç (14 raste), 51-64 vjeç (13 raste) dhe 65+ (28 raste). Gjatë javës së pestë (26.01.2026-01.02.2026), nga laboratorët private janë raportuar gjithsej 49 mostra të testuara si të dyshimta në SARS-CoV-2. Nga këto mostra nuk është konfirmuar asnjë rast pozitiv. Nga patogjenët tjerë respiratorë, janë konfirmuar: 214 mostra me RSV, 289 mostra me Human Rhinovirus, 155 mostra me Human Adenovirus, 27 mostra me Parainfluenza Virus dhe 15 mostra me Metapneumovirus (*Graf.5*). Rastet pozitive në RSV (13.5%), janë nga komuna e Prishtinës (89 raste), Fushë Kosovë (30 raste), Ferizaj (16 raste), Malishevë (11 raste), Podujevë (10 raste), Lipjan (5 raste), Obiliq (4 raste), Prizren (4 raste), Gjilan (4 raste), Suharekë (4 raste), Viti (4 raste), Drenas (4 raste), Mitrovicë (3 raste), Vushtrri (3 raste), Kaçanik (3 raste), Rahovec (2 raste), Hani i Elezit (2 raste), Kamenicë (2 raste), Klinë (2 raste), Shtime (2 raste), Deçan (2 raste) dhe me nga 1 rast komuna: Graçanicë, Gjakovë, Istog, Novobërdë, Skenderaj dhe Pejë. Rastet pozitive me RSV i takojnë grup-moshës 0-4 vjeç (190 raste), 5-14 (11 raste), 15-34 (4 raste), 35-50 (1 rast), 51-64 (1 rast) dhe 65+ (6 raste) (*Graf.5*).

#### *Grafikoni.5*



Sipas subtipit: me subtipin AH3: 32 mostra apo 10%, me subtipin AH1N1 12 mostra apo 4% dhe me Influençë A të pa subtipizuar 283 mostra apo 86%. (*Graf.6.*)

#### *Grafikoni. 6*



### **AKTIVITETET SEZONALE**

IKSHPK/Departamenti i Epidemiologjisë bënë mbikëqyrjen e Influcencës gjatë tërë vitit, me intensifikim të saj gjatë sezonës përkatëse (java e 40 deri në javën e 20).

Përcjell situatën epidemiologjike me rastet ILI/ARI (javore) dhe rastet me SARI (në bazë ditore/alerti).

Bënë testimin laboratorik të mostrave në Departamentin e Mikrobiologjisë/Qendrën Kombëtare për Testimin e Influcencës.

Ka dhënë këshilla për popullatën për mbrojtjen nga sëmundja dhe njohjen e simptomeve të saj.

### **MASAT PËR PARANDALIMIN E PËRHAPJES SË VIRUSIT TË GRIPIT SEZONAL**

Aktiviteti i gripit për sezonën 2025/2026, është në nivel më të ulët krahasuar me sezonën paraprake dhe masat për parandalimin dhe kontrollin e infeksioneve respiratore janë:

Mbajtja e maskave.

Distanca fizike.

Higjiena e duarve.

Evitimi i kontakteve të afërta me individë të sëmurë.

Redukimi i vizitave të familjarëve tek personat e hospitalizuar (SHSKUK, Spitalet rajonale).

Evitimi i vendeve të mbyllura dhe të mbingarkuara me njerëz.

Ushqimi i shëndetshëm me shumë vitamina.

Aktiviteti fizik dhe gjumë i mjaftueshëm.

Personat e sëmurë të qëndrojnë në shtëpi.

- Pastrimi dhe dezinfektimi i mjediseve ku qëndroni.

- Mbulimi i hundës dhe gojës me një shami gjatë teshtitjes dhe kollitjes si dhe hudhja më pas në vend të sigurt.
- Larja e duarve shpesh me ujë dhe sapun, ose solucione duarsh me alkool.
- Sytë, hunda dhe goja të mos preket me duar të kontaminuar, pasi virusi përhapet në këtë mënyrë.
- Pastrimi dhe dezinfektimi i sipërfaqeve dhe objekteve që mund të jenë kontaminuar nga virusi.

### **Konsultimi me mjekun për mjekimin me barna kundër gripit, të cilat duhet të merren vetëm me rekomandimin e mjekut**

Medikamentet kundër gripit duhet të fillohen brenda 48 orëve të para të fillimit të sëmundjes për të pasur efektivitet të lartë.

Ato mund të parandalojnë edhe komplikimet e rënda që mund të vijnë nga gripit.

Mënyra më efikase për parandalimin e virusit të gripit është Vaksinimi me vaksinën kundër gripit.

- Vaksinimi mbron vetë personin dhe ndihmon në parandalimin e përhapjes së gripit.
- Efekti i vaksinës fillon 1 deri 2 javë pas marrjes dhe mbrojtja vazhdon rreth një vit pas vaksinimit.

## **VAKSINIMI**

Ministria e Shëndetësisë në bashkëpunim me IKSHPK në fillim të sezonës së gripit 2025/2026 ka siguruar 85,000 doza të vaksinës sezonale dhe me fillimin e sezonës ka filluar vaksinimi sipas rekomandimeve.

Deri më 31 dhjetor 2025 janë administruar gjithsej 66,314 doza të vaksinës kundër gripit sezonal. Prej tyre sipas grupeve të rrezikut: 44,347 janë administruar te grup-mosha mbi 65 vjeç, 20,142 me sëmundje kronike, 1,287 profesionistë shëndetësor, 6 gra shtatëzëna, 49 fëmijë (0-5 vjeç), 195 zyrtarë policorë dhe 30 mësimdhënës dhe të tjerë 258.

## **HOSPITALIZIMET**

Gjatë javës së fundit nga rastet e hospitalizuara në Klinikën Infektive, Klinikën e Pediatriisë dhe spitalet rajonale janë raportuar 38 raste me ARI, 2 raste me ILI dhe 4 raste me SARI.

Nga Klinika Infektive deri më 01 shkurt 2026, janë raportuar 3 raste të vdekjes me Influcë A. Dy nga rastet i përkasin gjinisë mashkullore dhe një gjinisë femërore; i takojnë grup-moshës mbi 65 vjeç dhe me sëmundje kronike përcjellëse.

## INFLUENCA SEZONALE JAVA 05/2026 NË EVROPË

Të dhënat e mbikëqyrjes epidemiologjike për javën e pestë, tregojnë se trendin i infeksioneve respiratore si: Sëmundje e Ngjashme me Gripin (ILI) dhe/ose Infeksionet Akute Respiratore (ARI) mbeten mbi nivelin bazë në shumicën e vendeve të Rajonit Evropian të OBSH-së. Pas disa javësh rënie, pozitiviteti i Influcës në mbikëqyrjen sentinel në kujdesin parësor është rritur në disa vende, kryesisht i nxitur nga fëmijët e grupmoshës 5–14 vjeç, ndërkohë që indikatorët e mbikëqyrjes spitalore vazhdojnë të bien, me grup moshën 65 vjeç e lart që përbën përqindjen më të madhe të hospitalizimeve. Influenca A(H3) vazhdon të dominojë, megjithëse vërehet rënie graduale dhe rritje e bashkë-qarkullimit të A(H1)pdm09 në disa vende. Aktiviteti i SARS-CoV-2 mbetet në nivele bazë me pozitivitet të ulët. Aktiviteti i RSV vazhdon të rritet si në mbikëqyrjen në kujdesin parësor ashtu edhe në atë spitalore, me barrë më të lartë të sëmundjes dhe pozitivitet më të madh tek fëmijët nën moshën 5 vjeç. Influenca vazhdon të kontribuojë ndjeshëm në hospitalizime, ndërsa SARS-CoV-2 dhe RSV mbeten në nivele të ulëta.

Vdekshmëria nga COVID-19 vazhdon të jetë e ulët, megjithatë vërehet rritje e vdekshmërisë së përgjithshme, kryesisht në grup moshat mbi 65 vjeç, duke theksuar nevojën për vazhdimin e mbikëqyrjes së integruar të infeksioneve respiratore, me fokus në grupet në rrezik.. Burimi: <https://erviss.org/>